LIGJ
Nr. 54/2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9232, DATË 13.5.2004 "PËR PROGRAMET SOCIALE PËR STREHIMIN E BANORËVE TË ZONAVE URBANE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:
"PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT".

Neni 2

Në nenin 1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.".

Neni 3

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

"11. "Persona juridikë privatë" janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga legjislacioni në fuqi.".

2. Pas pikës 17 shtohen pikat 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 e 27 me këtë përmbajtje:

"18. "Emigrant i rikthyer" janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

19. "Punëtor emigrant" janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9555, datë 8.6.2006 "Për ratifikimin e konventës europiane "Për statusin ligjor të punëtorëve emigrantë"".

20. "Familjet e policëve të rënë në detyrë" janë të gjitha kategoritë që përfshihen në ligjin nr. 10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës".

21. "Persona me aftësi të kufizuara (PAK)" janë kategoritë që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe që përfshihen në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të ndryshuar.

22."Viktima të dhunës në familje" janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

23. "Grant i menjëhershëm" është një sasi të hollash që përfitojnë, pa të drejtë kthimi, disa kategori të specifikuara, në masën e përcaktuar në këtë ligj dhe sipas procedurës që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

24. "Grante të vogla" janë grante konkurruese që shpallen nga ministria që mbulon strehimin, për financimin, e plotë ose të pjesshëm, të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga organet e qeverisjes

vendore, në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim nga ministria, për qëllime të këtij ligji.

25. “Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuara dhe përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës apo të luftës, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen ato nga rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë, paketa higjieno - shëndetësore për PAK-të, pagesa për kujdestarin për PAK-të, kur ky/kjo nuk është anëtar i familjes.

26. “Të ardhura mesatare” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të dizagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike.

27. “Punonjës të Policisë së Shtetit” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.”.

Neni 4

Në nenin 3 pika 1 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjat “a” dhe “b”, fjalët “organizata jofitimprurëse” zëvendësohen me fjalët “persona juridikë privatë”.

2. Në shkronjën “c”, fjalët “plani rregullues urbanistik” zëvendësohen me fjalët “plani i përgjithshëm vendor”.

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Përcaktimi i familjeve që përfitojnë nga programet sociale të strehimit

1. Sipas këtij ligji, përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;

c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

2. Përfshihen në njërën nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të neneve 6 e 19 të këtij ligji.

3. Përfitojnë sipas programeve të përcaktuara në krerët III dhe IV të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin:

a) “punëtor emigrant”;

b) “azilkërkues”.

4. Administrimi i kërkesave për përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga strukturat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore dhe miratohen me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, përveç rasteve kur në ligje të veçanta përcaktohet ndryshe.

5. Dokumentacioni, që duhet të paraqesë familja për të përfituar strehim, sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe afatet e procedurat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Normat për përfitimin e strehimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

1. Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi, me anë të të cilit vlerësohen:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.

c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;

ii) personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç;

iii) emigranti i rikthyer, punëtor emigrant;

iv) familjet e policëve të rënë në detyrë;

v) viktimat e dhunës në familje.

ç) Gjendja ekonomike, në bazë të së cilës përcaktohen familjet sipas grupeve të të ardhurave.

2. Sistemi i pikëzimit miratohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për çdo program që zbatohet në një njësi të qeverisjes vendore dhe bazohet në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur programi zbatohet me financim, të plotë ose të pjesshëm, të Buxhetit të Shtetit, ministria, që mbulon çështjet e strehimit, në raport me masën e financimit dhe në bashkërendim dhe në marrëveshje me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, mund të kushtëzojë një sistem pikëzimi, që favorizon kategori, të cilat kanë përparësi në politikat kombëtare, si personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët emigrantë, emigrantët e rikthyer, familjet e policëve të rënë në detyrë. Marrëveshja, përveç sistemit të pikëzimit, për kategoritë e sipërpërmendura, përfshin edhe angazhimin për mbulimin e shpenzimeve, sipas pikës 2 të nenit 24 të këtij ligji.

4. Në objektet e reja që ndërtohen, organet e qeverisjes vendore, në përzgjedhjen e përfituesve marrin parasysh si kriter edhe përzierjen e grupeve të ndryshme sociale, me qëllim që të shmanget veçimi social.".

Neni 7

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1
Transparenca

Organet e njësive të qeverisjes vendore duhet të sigurojnë:

1. Informacion të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm, edhe nga persona me mungesë shikimi. Informacioni duhet të përmbajë:

a) llojin e programit social të strehimit që zbatohet në atë njësi të qeverisjes vendore;

b) kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t'u përfshirë në programin specifik të strehimit;

c) dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar;

ç) procedurën që do të ndiqet nga njësia e qeverisjes vendore për miratimin e përfituesve;

d) organin ankimor, të cilit duhet t'i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues, afatet kohore dhe formatin e ankimit.

2. Transparencë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve, nëpërmjet publikimit të sistemit të pikëzimit dhe vënies në dispozicion, për të interesuarit që nuk janë përzgjedhur, të tabelës përmbledhëse të pikëzimit të të gjithë aplikantëve.

3. Ndihmë për plotësimin e formularëve të aplikimit për strehim për personat me mungesë shikimi, për ata që nuk kuptojnë gjuhën shqipe apo ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe të sigurojnë që edhe grupe a individë, që kanë vështirësi komunikimi, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore apo sociale, të marrin informacionin e nevojshëm për këtë qëllim.".

Neni 8

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Përcaktimi i kufijve të të ardhurave

1. Jo më pak se 80 për qind e familjeve që trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

2. Pjesa tjetër mund të përzgjidhet brenda intervalit 100 – 120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare. Kjo kategori paguan një qira më të lartë se kategoritë e tjera, por jo më shumë se 30 për qind të të ardhurave mujore.

3. Për vitin e parë të zbatimit dhe në mungesë të të dhënave, sipas pikës 2 të këtij neni, merret për bazë niveli i të ardhurave mesatare të disponueshme dhe të indeksuara me ndryshimin e nivelit të pagave.".

Neni 9

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qira

1. Me administrim kuptohen të gjitha veprimet dhe vendimet që merren për pronën, ndër të tjera:

a) vjelja e qirasë;

b) evidenca e të ardhurave dhe shpenzimeve;

c) planifikimi financiar;

ç) mbajtja e bilancit;

d) ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve e të drejtave të palëve kontraktuese.

2. Me mirëmbajtje kuptohen tërësia e veprimeve dhe investimet e nevojshme për punime të zakonshme dhe riparime kapitale për përmirësimin e pronës.

3. Mënyra e administrimit dhe e mirëmbajtjes së banesave sociale me qira përcaktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Banesat me qira, si rregull, administrohen në bazë të një kontrate me entet menaxhuese, të cilat janë persona juridikë, publikë ose privatë, ose persona fizikë, të regjistruar në njërën prej formave të përcaktuara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e personave juridikë.

4. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat kanë një numër të kufizuar banesash sociale për të menaxhuar, mund të ngarkojnë punonjës të njësisë së qeverisjes vendore për administrimin.

5. Enti menaxhues regjistrohet në njësinë e qeverisjes vendore, sipas kritereve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Enti menaxhues duhet të ketë në përbërje personel të specializuar në fushat e mëposhtme:

a) juridike;

b) sociale;

c) financiare;

ç) ndërtimore.".

Neni 10

Pas nenit 9 shtohen nenet 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
Kontraktimi i entit menaxhues

Kontrata me entin menaxhues është e vlefshme, kur kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ka kryer një procedurë prokurimi për shërbimin, sipas kuadrit ligjor përkatës. Kontrata me entin menaxhues emërtohet si "Kontratë shërbimi që ka për objekt menaxhimin e banesave sociale".

Neni 9/2
Standardet e menaxhimit të banesave sociale me qira

Çdo organ i qeverisjes vendore duhet të sigurojë që menaxhimi i banesave sociale bëhet në përputhje me standardet e mëposhtme:

1. Angazhimin dhe fuqizimin e qiramarrësve, duke siguruar:

a) trajtimin e të gjithë qiramarrësve në mënyrë të barabartë;

b) informimin e duhur për qiramarrësit për llojin dhe standardin e shërbimeve që ata mund të presin nga enti menaxhues, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me menaxhimin e banesave;

c) forma të qarta dhe të thjeshta për paraqitjen e ankesave dhe që sigurojnë zgjidhjen e shpejtë, të drejtë dhe të kujdesshme për ta;

ç) mundësi të ndryshme për qiramarrësit që të angazhohen në menaxhimin e banesave të tyre;

d) format dhe mënyrat që qiramarrësit të kontrollojnë dhe të sigurojnë zbatimin e standardeve të menaxhimit.

2. Kushte të përshtatshme të banimit, duke siguruar:

a) që banesa e qiramarrësit të jetë në përputhje me standardet e ndërtimit;

b) që mirëmbajtja e banesave të jetë e tillë që të sigurojë, së paku, standardet, në bazë të të cilave ajo është ndërtuar ose blerë;

c) të gjitha standardet për sigurinë dhe kushtet higjieno-shëndetësore të banesave.

3. Fqinjësinë e mirë, duke siguruar:

a) informacionin e mjaftueshëm për qiramarrësit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre për marrëdhëniet e fqinjësisë, respektimin e privatësisë, ruajtjen e qetësisë e të pastërtisë, shmangien e sjelljeve e të veprimeve ofenduese, keqdashëse apo të atyre kriminale;

b) veprim të menjëhershëm ndaj veprimeve që shqetësojnë ose vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e banorëve.

4. Qëndrueshmërinë dhe transparencën financiare, duke siguruar, ndër të tjera:

a) transparencën në përcaktimin e qirasë për çdo qiramarrës;

b) mbledhjen e qirave në kohë dhe evidentimin e çdo shkeljeje të këtij afati;

c) menaxhimin e rasteve të debitorëve, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar zgjidhjet e duhura;

ç) auditin e brendshëm dhe kontrollin financiar nga strukturat përkatëse shtetërore dhe vendore.".

Neni 11

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët "entit menaxhues" dhe fjala "familjes" zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët "kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore ose personit të autorizuar prej tij" dhe fjalën "kryefamiljarit".

2. Fjalia e fundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"Afati i njoftimit për lirimin e banesës përcaktohet në dispozitat e kontratës.".

Neni 12

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Zgjidhja e kontratës së qirasë

1. Kontrata e qiramarrjes zgjidhet kur:

a) qiramarrësi bën deklarim të rremë për të ardhurat;

b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;

c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti;

ç) qiramarrësi, pa arsye të justifikuara, nuk ka paguar qiranë për 3 muaj rresht. Sipas këtij ligji, termi "arsye të justifikuara" nënkupton raste të tilla, si sëmundje e rëndë e papritur, që bëhet shkak për rritjen e shpenzimeve, papunësi e papritur apo humbja e një pjesëtari të familjes që siguronte të ardhurat;

d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Pas zgjidhjes së kontratës, qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirimin e banesës. Në të kundërt, enti menaxhues njofton autoritetet e policisë së njësisë së qeverisjes vendore, të cilat janë të detyruara të realizojnë lirimin e banesës.

Neni 13

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 12/1
Pronësia e banesave sociale me qira

1. Banesat sociale me qira regjistrohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, përveç rasteve kur në marrëveshjet e financimit është caktuar ndryshe.

2. Kur banesat sociale me qira financohen, pjesërisht ose tërësisht, nga Buxheti i Shtetit, ato regjistrohen në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pronave, në emër të njësisë së qeverisjes vendore dhe me barrë hipotekore, që pengon privatizimin e tyre.

3. Trualli, mbi të cilin janë ndërtuar banesat sociale me qira, përjashtohet nga taksa mbi truallin shtetëror në përdorim.

Neni 12/2
Qiraja financiare

1. Kontrata e qirasë financiare, sipas kuptimit të nenit 849 të Kodit Civil, lidhet ndërmjet qiradhënësit, i cili është pronari i banesës sociale me qira, dhe qiramarrësit, për një afat jo më të vogël se 20 vjet.

2. Gjatë periudhës së qiramarrjes, qiramarrësi është i detyruar të paguajë në mënyrë periodike vlerën e qirasë, të përcaktuar sipas nenit 11 të këtij ligji.

3. Qiramarrësit i lind e drejta për të fituar pronësinë e banesës, në mbarim të afatit të përcaktuar në kontratën e qirasë.

4. Kalimi i pronësisë bëhet me miratim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, përkundrejt shlyerjes së vlerës që përcaktohet, rast pas rasti, dhe duke pasur parasysh masën e vlerës së investimit dhe menaxhimit që ka paguar qiramarrësi. Kur financimi i banesave sociale është bërë me fonde buxhetore, shlyerja e investimit llogaritet për 25 vjet.

5. Kur banesat sociale me qira janë financuar, pjesërisht a tërësisht, nga Buxheti i Shtetit, privatizimi i banesave bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton kriteret, procedurat dhe vlerën e privatizimit.".

Neni 14

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Njësitë e qeverisjes vendore, me miratim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore përkatëse, i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, e cila plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, bonus strehimi kur:”.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është përcaktuar sipas pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji.”.

3. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) kur familja ka ngelur e pastrehë, si rezultat i një fatkeqësie natyrore ose për shkak të ekzekutimit të vendimit të përmbarimit apo kthimit të detyruar të shtetasit shqiptar që ka qenë me qëndrim të parregullt në një vend të huaj ose azilkërkues.”.

Neni 15

Në nenin 14, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Këshilli i Ministrave miraton procedurat, kriteret dhe përparësitë e dhënies së bonusit të strehimit, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, për kategori të përcaktuara në pikën 2 të nenit 24 të këtij ligji.”.

Neni 16

Në nenin 16 pika 1, fjalët “lëshimit të bonusit” zëvendësohen me fjalët “miratimit të bonusit”.

Neni 17

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Përcaktimi i nivelit të të ardhurave të familjeve që përfitojnë banesë me kosto të ulët

1. Përzgjidhet për t’u trajtuar me banesë me kosto të ulët, familja me të ardhurat maksimale mujore jo më të larta se 120 për qind e të ardhurave mesatare, të përcaktuara për prefekturën.

2. Kur banesa me kosto të ulët sigurohet përmes blerjes nga tregu, nëpërmjet një kredie hipotekore nga bankat e nivelit të dytë, me interesa të lehtësuar nga shteti, niveli maksimal i të ardhurave llogaritet nga ministria që mbulon fushën e strehimit, bazuar në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg për çdo qytet, normat e strehimit, kushtet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë dhe treguesin e aftësisë paguese jo më shumë se 30 për qind.”.

Neni 18

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Subvencionimi i qirasë

1. Kur qiraja e banesës sociale zë më shumë se 25 për qind të të ardhurave neto të familjes, sipas shkronjës “a” të nenit 5 të këtij ligji, kjo e fundit përfiton subvencionim të qirasë. Shuma e subvencionimit llogaritet e barabartë me diferencën ndërmjet qirasë së synuar dhe asaj të përballueshme. Masa e subvencionimit miratohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Përparësi në subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit kanë kategoritë e mëposhtme:

a) personat me statusin e jetimit;

b) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;

c) familjet e policëve të rënë në detyrë;

ç) emigrantët e rikthyer;

d) punëtori emigrant;
dh) familjet e komunitetit rom;
e) punonjësit e Policisë së Shtetit.”.

Neni 19

Pas nenit 25 shtohen nenet 25/1 dhe 25/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1
Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët

1. Përfitojnë grant të menjëhershëm familjet që plotësojnë kushtin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 18 të këtij ligji, të cilat kanë në përbërje:

a) një person me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;

b) një person me statusin e jetimit, i cili në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç.

2. Shuma e grantit të menjëhershëm të mos jetë më e madhe se 10 për qind e vlerës së banesës që përfiton personi.

3. Granti i menjëhershëm akordohet nga Buxheti i Shtetit, sipas procedurave, kritereve dhe përparësive që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25/2
Grantet e vogla

1. Buxheti i Shtetit ndihmon me grante të vogla organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom.

2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe të dhënies së granteve të vogla përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin, sa herë planifikohen fonde.”.

Neni 20

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32
Kushtet për përfitimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit

1. Organi i qeverisjes vendore përfiton nga fondet e investimeve të Buxhetit të Shtetit për ndërtimin e banesave sociale dhe/ose atyre me kosto të ulët kur:

a) ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat ekzistuese;

b) ka hartuar planin 10-vjeçar të strehimit;

c) ka parashikuar zonat e ndërtimit të banesave në instrumentin vendor të planifikimit urban;

ç) ka dërguar informacionin vjetor me të dhënat, sipas shkronjës “ç” të nenit 35 të këtij ligji.

2. Aplikimi për fonde strehimi sipas këtij ligji miratohet me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin.”.

Neni 21

Në nenin 39/1 bëhen shtesat si më poshtë:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Banesat e ish-pronarëve, të zëna nga qytetarët, të cilët janë përfitues të kredisë me interes 0 për qind, lirohen nga organet e njësisë së qeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga data e lëvrimit të kredisë, përveç rasteve kur ka marrëveshje noteriale me pronarin/pronarët, nëse familja nuk liron banesën vullnetarisht.”.

b) Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Banesat dhe objektet e kthyera në fond banese me vendime të organeve të qeverisjes vendore, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, si dhe ato që figurojnë ende në pronësi të shtetit, ku, me autorizime të dhëna nga organet kompetente, janë sistemuar me strehim banorë përpara daljes së këtij ligji, mund të privatizohen në favor të banorëve, sipas listës me autorizimet përkatëse dhe sipas procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Banesat e ndërtuara për familjet e shpërngulura, për shkak të ndërtimit të veprave publike, të tilla si Hidrocentrali i Banjës, Hidrocentrali i Fierzës, Ujëmbledhësi i Bovillës e të ngjashme me këto, të cilat ende figurojnë të paprivatizuara, privatizohen falas me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe sipas listës emërore që kanë trashëguar. Familjet, emrat e të cilave nuk figurojnë në listat e trashëguara, të miratuara nga njësitë e qeverisjes vendore, nuk përfitojnë nga privatizimi falas, por trajtohen sipas pikës 4 të këtij neni.”.

Neni 22

Në të gjithë ligjin:

a) fjala “bashki” zëvendësohet me fjalët “njësi e qeverisjes vendore”;

b) fjalët “zyra përkatëse në bashki” zëvendësohen me fjalët “struktura përkatëse në njësitë e qeverisjes vendore”;

c) fjalët “këshill bashkiak” zëvendësohen me fjalët “këshill i njësisë së qeverisjes vendore”; dhe

ç) fjalët “kryetar i bashkisë” zëvendësohet me fjalët “kryetar i njësisë së qeverisjes vendore”.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.5.2012

Shpallur me dekretin nr. 7494, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi